

URDHËR
Nr. 181, datë 27.10.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 102, të pikës 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; të vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar; të vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”; të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar, të vendimit nr. 243, datë 15.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr. 22, datë 10.7.2013, të ministrit të Financave, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor Sekretarit të Përgjithshëm, për të gjitha procedurat e prokurimit publik, për Ministrinë e Punëve të Brendshme.
2. Delegimin e kompetencave Sekretarit të Përgjithshëm, për nënshkrimin e urdhrave për shërbimet jashtë vendit për nëpunësit e aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe nënshkrimin e program-urdhrave për aktivitetet zyrtare për pritjen dhe përcjelljen e delegacioneve të huaja të zhvilluara brenda dhe jashtë institucionit, pas miratimit të kërkesave nga titullari i institucionit.
3. Delegimin e kompetencave Sekretarit të Përgjithshëm, për të autorizuar dërgimin me shërbim të punonjësve të Aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme jashtë qendrës së punës, brenda vendit, me largësi mbi 100 km.
4. Kompetencat e deleguara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij urdhri, mbarojnë me shfuqizimin e këtij urdhri, ose me pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, si dhe nëpunësit e aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij urdhri.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri shfuqizohet çdo urdhër tjetër që bie në kundërshtim me të. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Albana Koçiu